



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova
Ministry of Foreign Affairs



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

SHKOLLËS ESTONEZE TË DIPLOMACISË¹

Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës dhe Shkolla Estoneze e Diplomacisë, këtej e tutje të referuar si (“Nënshkruesit”).

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Estonisë dhe Kosovës dhe të GATSHËM për të promovuar bashkëpunimin më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve;

Kanë rënë dakord si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Objektivi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është që të krijojë kushtet për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Neni 2

Bashkëpunimi

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave përkitazi me programet e tyre përkatëse të studimit dhe hulumtimit, seminareve dhe aktiviteteve tjera akademike dhe të trajnimit.

Palët mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit në kuadër të objektivave të këtij memorandumi.

Neni 3

Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të promovojnë kontaktin dhe shkëmbimin e stazhierëve, ekspertëve dhe hulumtuesve.

Palët do të inkurajojnë studimin dhe hulumtimin, si dhe shkëmbimin e informatave mbi publikimet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushat me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i informatave

Palët do të shkëmbejnë informata dhe pikëpamje në lidhje me trendet ndërkombëtare dhe përparimet në trajnim dhe studime në diplomaci, politikë të jashtme, marrëdhënie ndërkombëtare, të drejtën ndërkombëtare, marrëdhënie ekonomike me jashtë, shkenca politike si dhe fusha tjera relevante.

Neni 5

Projektet e ndërmarra bashkërisht

Palët do të vendosin, përmes kanaleve përkatëse diplomatike, specifikat dhe logjistikën e secilit projekt që ata marrin përsipër bashkërisht. Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të nxirren protokollat që përcaktojnë termat dhe kushtet e shkëmbimeve të propozuara.

Neni 6

Kushtet financiare

Për format, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të shkëmbimeve dhe trajnimit të përfaqësuesve të Nënshkruesve, do të bihet dakord ndërmjet Nënshkruesve.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur më interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve, përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokollit mund të ndryshohen përmes pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij, dhe do të vazhdojë të ketë efekt për një periudhë prej tre vjetësh. Pas kësaj, ky mund të ripërtërihet automatikisht për periudha të njëjta, përveç nëse ndërpritet nga ndonjëra Palë, duke i dhënë një njoftim me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve Palës tjetër, para datës së përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikoj në projektet që janë në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

BËRË në Tallinn, më 18 Tetor 2014, në dy kopje origjinale në Gjuhën Angleze, që janë njëjloj autentike.

Për Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës

Për Shkollën Estoneze të Diplomacisë

Z. Skender Durmishi, Drejtor

Z. Ekke Nomm, Drejtor